



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës / Tužilaški Savet Kosova / Kosovo Prosecutorial
Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 pika 9 e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligjin për Prokurorin e Shtetit, Memorandumin e Bashkëpunimit për themelimin dhe funksionalizimin e Koordinatorit Kombëtarë për ndjekjen e kryesve të veprave penale dhe konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale, dhe Planin Strategjik për bashkëpunim ndërinstytucional në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, në mbledhjen e mbajtur me datë 1 nëntor 2013, nxjerr këtë:

Rregullore për themelimin dhe funksionalizimin e Koordinatorit Kombëtarë me qëllim të rritjes së efikasitetit në ndjekjen e kryesve të veprave penale, sekuestrimin dhe konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale. (Në tekstin e mëtejshëm: Koordinatorit Kombëtarë për Luftimin e Krimit Ekonomik).

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i rregullores

Qëllimi i kësaj rregullore është themelimi dhe funksionalizimi i Koordinatorit Kombëtarë për Luftimin e Krimit Ekonomik (tani e tutje "Koordinatori Kombëtarë").

Neni 2
Funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e Koordinatorit kombëtarë

1. Koordinatori Kombëtarë do të ketë këto kompetenca dhe përgjegjësi që dalin nga memorandumi i bashkëpunimit, duke përfshirë:
 - 1.1 Koordinim të aktiviteteve për vetëdijesim të të gjitha agjencive nënshkruese të këtij Memorandumi, rreth rrezikut që ndërlidhet me dështimet dhe sukseset në luftën kundër krimeve që gjenerojnë përfitime materiale, përmes mediave dhe mjeteve tjera;

- 1.2 Mbikëqyrjen e hartimit dhe realizimit të planeve të veprimit të krijuara për të arritur dhe mirëmbajtur përmbushjen e standardeve ndërkombëtare për shpëlarje të parasë;
- 1.3 Koordinim të aktiviteteve të reagimit Kombëtarë ndaj kërkesave të organizatave ndërkombëtare për realizim të ekzaminimeve ose vlerësimeve kundër shpëlarjes së parasë;
- 1.4 Mbikëqyrje të planifikimit dhe realizimit të programeve të trajnimit që lidhen me mandatin e Institutit për Krime Ekonomike;
- 1.5 Identifikimin e mundësive për përmirësim, praktika më të mira dhe procedura operuese që mund të përmirësojnë efikasitetin dhe efektivitetin e programit dhe komunikimin e kësaj informate tek autoritetet e përshtatshme;
- 1.6 Grumbullimin dhe analizën e informative lidhur me efikasitetin dhe efektivitetin e institucioneve të involvuara në luftën kundër krimeve që gjenerojnë përfitime materiale dhe raportimin e kësaj informate tek autoritetet e përshtatshme;
- 1.7 Sigurimin e mbështetjes administrative dhe funksionale për arritjen e objektivave të strategjive Kombëtarë për luftim të shpëlarjes së parasë, financim të terrorizmit dhe ekonomi joformale; dhe
- 1.8 Rekomandimin e modifikimeve në strategjinë Kombëtare ose legjislacion që do të përmirësonte përputhjen me standardet ndërkombëtare kundër shpëlarjes së parasë ose rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të programit.

Neni 3

Struktura e Koordinatorit Kombëtare

1. Këshilli Prokurorial i Kosovës me vendim do të caktoj një prokuror me mandat të përhershëm dhe me ekspertizë në fushën e krimeve ekonomiko-financiare dhe njohuri të gjuhës angleze në pozitën e Koordinatorit Kombëtare.
2. Koordinatori Kombëtarë përveç prokurorit do të ketë Këshilltar ligjor, i cili do të sigurohet nga Policia e Kosovës, zyrtar me përvojë dhe ekspertizë në fushën e krimeve ekonomiko-financiare dhe me njohuri të mira të gjuhës angleze, Asistent personal, i Koordinatorit Kombëtarë, i cili do të sigurohet nga Policia

e Kosovës, me përvojë dhe ekspertizë në fushën e krimeve ekonomiko-financiare dhe me njohuri të mira të gjuhës angleze dhe vozitësin.

3. Tërë stafi tjetër i caktuar me detyrë në strukturën e Koordinatorit kombëtarë pa marrë parasysh a është staf i Këshillit Prokurorial të Kosovës ose është deleguar prej ndonjë agjenci apo institucion tjetër me orar të shkurtë apo të plotë do t'i raportojë Koordinatorit Kombëtarë përderisa ushtrojnë detyrat e caktuara për këtë institucion. Të gjitha agjencitë e përfaqësuara përmes nënshkruesve të memorandumit të bashkëpunimit do të inkorporojnë vlerësimin e Koordinatorit Kombëtarë kur të vlerësohet performanca e stafit të deleguar.
4. Stafi i deleguar sipas paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni do të ushtrojë funksionin e tij në kuadër të Koordinatorit Kombëtarë në kohëzgjatje që e përcakton institucioni që e delegon, por jo më pak se një vit.
5. Gjatë kohës së ushtrimit të detyrave të tyre në Koordinatorin Kombëtarë, stafi, përfshirë këtu edhe prokurorin e caktuar për të udhëhequr me Koordinatorin Kombëtarë do të pranojnë pagën dhe beneficinet që dalin nga marrëdhënia e punës në institucionin ku kanë punuar para se të caktohen në Koordinatorin Kombëtarë por nuk do të mund të ushtrojnë detyrat e tyre në institucionet përkatëse, për sa kohë shërbejnë në Koordinatorin Kombëtarë.
6. Prokurori i Shtetit do të sigurojë hapësirë punë për Koordinatorin Kombëtarë dhe stafin mbështetës.

Neni 4

Koordinimi dhe bashkëpunimi i Koordinatorit Kombëtarë me ministritë, institucionet dhe agjencitë tjera

Koordinatori Kombëtarë do të kryejë të gjitha detyrat që ndërlidhen me fushëveprimtarinë e tij dhe që kanë për qëllim kryerjen e detyrave dhe përgjegjësisë të përcaktuara me Memorandumin e Bashkëpunimit,

Neni 5

Monitorimi i efektivitetit

1. Koordinatori Kombëtarë do të monitorojë punën e të gjitha institucioneve relevante në Republikën e Kosovës lidhur me procesimin e rasteve që hyn në kuadër të kësaj rregulloreje dhe memorandumit të bashkëpunimit.

2. Institucionet relevante do të raportojnë në baza tre mujorë lidhur me paragrafin 1 të këtij neni në formën e raporteve statistikore dhe analitike.
3. Koordinatori Kombëtarë do të monitorojë dhe përcjellë procedimin e rasteve nga institucioni në institucion.
4. Koordinatori Kombëtarë mund të propozojë udhëzime për institucionet në fjalë se si të përmirësojnë nivelin e performancës dhe raportimit.

Neni 6

Mënyra e raportimit të ministrive, institucioneve dhe agjencive të Koordinatorit Kombëtarë

1. Në pajtim me memorandumun e bashkëpunimit institucionet e Republikës së Kosovës përmes raporteve tre mujore do të informojnë Koordinatorin Kombëtarë.
2. Varësisht nga natyra e punës dhe fushëveprimi përkatës, ndër tjera institucionet do të informojnë për :
 - 2.1 Numri i rasteve të hapura me prioritet të lartë të pranuar për ndjekje penale me asetet e identifikuar mirëpo ende të pa-sekuestruara nga gjyqtari i procedurës paraprake.
 - 2.2 Numri i aseteve dhe vlera e parashikuar e instrumenteve të sekuestruara nga gjyqtari i procedurës paraprake, që ende nuk janë listuar në një aktakuzë.
 - 2.3 Numri i artikujve dhe vlera e parashikuar e benefiteve materiale të sekuestruara nga gjyqtari i procedurës paraprake, që ende nuk janë listuar në një aktakuzë.
 - 2.4 Numri i individëve të akuzuar për vepra penale për profit.
 - 2.5 Numri i individëve të akuzuar për shpërlarje të parasë.
 - 2.6 Numri i artikujve dhe vlerave të llogaritura të instrumenteve të listuara në një aktakuzë, mirëpo gjykata ende nuk ka dhënë urdhër për konfiskim.
 - 2.7 Numri i artikujve dhe vlera e llogaritur e benefiteve materiale të listuara në një aktakuzë mirëpo gjykata ende nuk ka dhënë urdhër për konfiskim.
 - 2.8 Numri i individëve të dënuar për vepra penale për profit.
 - 2.9 Numri i individëve të dënuar për shpërlarje të parasë.
 - 2.10 Numri i artikujve dhe vlera e parashikuar e instrumenteve për të cilat është dhënë urdhëri i gjykatës për konfiskim.
 - 2.11 Numri i artikujve dhe vlera e parashikuar e benefiteve materiale për të cilat gjykata ka lëshuar urdhërin për konfiskim.

- 2.12 Numri i artikujve dhe vlera e llogaritur e pronës për të cilën gjykata ka lëshuar urdhërin e konfiskimit përmes kompetencave të zgjeruara të konfiskimit.
- 2.13 Numri i artikujve dhe vlera e parashikuar e aseteve të sekuestruara që ende nuk është konfirmuar nga gjyqtari i procedurës paraprake.
- 2.14 Numri i artikujve dhe vlera e parashikuar e aseteve të sekuestruara të konfirmuara nga gjyqtari i procedurës paraprake, mirëpo ende nuk janë transferuar në AAPSK .
- 2.15 Numri i individëve të arrestuar mirëpo ende të pa-akuzuar.
- 2.16 Numri i individëve të arrestuar rastet e të cilëve janë hedhur poshtë nga prokurori.
- 2.17 Rastet e refuzuara me urdhër nga gjykata.
- 2.18 Numri i artikujve dhe vlera e parashikuar e pronës së sekuestruar paraprakisht- të kthyer të pandehurit.

Neni 7

Mbikqyrja e Koordinatorit Kombëtarë

- 1. Koordinatori Kombëtarë raporton drejtëpërdrejtë tek Këshilli Prokurorial i Kosovës lidhur me veprimtarinë e tij.
- 2. Koordinatori Kombëtarë do të përgatis raport me shkrim cdo tre muaj lidhur me veprimtarinë tij për miratim tek Këshilli Prokurorial I Kosovës.
- 3. Raportet e miratuara në Këshillin Prokurorial të Kosovës do të dërgohen për njoftim Bordit Këshilldhënës dhe do të publikohen në ueb faqen e KPK-së.
- 4. Vlerësimi I punës së stafit mbështetës të Koordinatorit Kombëtarë do të duhet të kryhet në përputhshmëri me parimet e ligjshmërisë, barazisë, objektivitetit dhe transparencës.
- 5. Pavarsisht rregullores, për vlerësimin e performances së prokuroreve, vlerësimi I performances së Prokurorit të caktuar në pozitën e Koordinatorit Kombëtarë, gjatë kohës që shërben në këtë pozite do të bëhet drejtëpërdrejtë nga KPK, duke marr parasysh specifikat e kësaj pozite.

Neni 8

Konfidencialiteti

Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në ligjet dhe/ose rregulloret tjera, të gjitha shënimet dhe informatat që mblidhen ose mbahen janë konfidenciale dhe nuk zbulohen.

Neni 9
Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Miratuar me 27 dhjetor 2013

Ismet Kabashi

Kryetar i Këshillit Prokurorial

